

VENDIM
Nr.590, datë 29.7.2010

**PËR DHËNIE NDIHMË FINANCIARE NJË KATEGORIE PERSONASH TË
STREHUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, dhe të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare prej 78 000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) lekësh në muaj, për pagesën e qirasë së banesës, të ushqimit, energjisë elektrike e të ujit, çdo shtetasi të huaj, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pagesa të kryhet nga strukturat e Ministrisë së Brendshme, sipas udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, në shumën e përcaktuar, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

1. Abdu Rrauf Omar
2. Salih Bib Al’Hadi Essasi
3. Sherif Fat’hi Almeshad

Lidhja nr.2 Efektet financiare

Nr	Emër/mbiemër	Qira	Ndihmë financiare	Muaj	Total ndihmë financiare
1.	Abdu Rrauf Omar	35 000	43 000	12	936 000
2	Salih Bin Al’Hadi Essasi	35 000	43 000	12	936 000
3	Sherif Fat’hi Almeshad	35 000	43 000	12	936 000
Totali/lekë					2 808 000

Për të gjithë shtetasit e sipërpërmendur është parashikuar mbulimi i shpenzimeve të qirave të banesave për një periudhë 12-mujore. Kjo, pasi këta shtetas kanë firmosur kontrata qeraje banese njëvjeçare me agjencinë imobiliare dhe gjykojmë që këto kontrata të përsëriten për një periudhë njëvjeçare.

Për të gjithë shtetasit e sipërpërmendur ndihma financiare është përlllogaritur për të mbuluar periudhën gusht 2010-gusht 2011.